



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**V E N D I M**

**Nr.1973, datë 01.06.2012**

**Për**

**“Miratimin e disa shtesave në Vendimin nr. 1648, datë 13.7.2011 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për Miratimin e Kushteve të Përgjithshme të Kontratës së Pajtimit (Kontratë Tip) së Albanian Mobile Communications sh.a., për shërbimin publik telefonik të qëndrueshëm”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 01.06.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Miratimin e disa shtesave në Vendimin nr. 1648, datë 13.7.2011 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për Miratimin e Kushteve të Përgjithshme të Kontratës së Pajtimit (Kontratë Tip) së Albanian Mobile Communications sh.a., për shërbimin publik telefonik të qëndrueshëm.

**BAZA LIGJORE:**

1. Neni 99 dhe neni 100 i ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*Ligji nr. 9918*);
2. Ligji nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” (*Ligji nr. 9902*);
3. Neni 15, e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
4. Pika 17, e nenit 21, të “Rregullores së Brendshme të AKEP” (*Rregullorja e*

**Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24. 04.2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3, të nenit 138, të ligjit nr. 9918;

## K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Shkresa nr. 1872 prot, datë 29.3.2012 “Njoftim në lidhje me përdorimin e formularit prepaid të telefonisë së qendrueshme nga ana e AMC sh.a” (AKEP: nr. 635, datë 29.3.2012);
  - Vendimi nr. 1648, datë 13.7.2011 i KD të AKEP “Për Miratimin e Kushteve të Përgjithshme të Kontratës së Pajtitimit (Kontratë Tip) së Albanian Mobile Communications sh.a., për shërbimin publik telefonik të qëndrueshëm”;
  - Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (**Relacioni**);
- si dhe duke i’u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

## V Ë R E N:

1. Sipërmarrësi, AMC sh.a, ka depozituar në AKEP shkresën nr. 1872, datë 29.3.2012 “Njoftim në lidhje me përdorimin e formularit prepaid të telefonisë së qendrueshme nga ana e AMC sh.a” (AKEP: nr. 635, datë 29.3.2012), bashkëlidhur “Formulari i regjistrimit me parapagesë në rrjetin e telefonisë fikse të AMC”;
2. AMC sh.a me anë të shkresës nr. 1872, datë 29.3.2012, në kuadër të lancimit në treg të shërbimit publik telefonik të qëndrueshëm me parapagesë kërkon nga AKEP miratimin e formularit të regjistrimit me parapagesë në rrjetin e telefonisë fikse;
3. AKEP konstaton se, formulari i regjistrimit me parapagesë në rrjetin e telefonisë fikse i depozituar për miratim nga AMC, përmban kushte dhe të dhëna të njëjta krahasuar me ato të formularit të rregjistrimit të miratuar me Vendimin nr. 1648, datë 13.7.2012, por me ndryshime të cilat i referohen llojit të shërbimit që AMC ofron për pajtimtarët me parapagesë apo kontratë;
4. AKEP, me qëllim që formulari i depozituar nga AMC të jetë në përputhje me kushtet e përgjithshme të Kontratës Tip me pajtimtarin e sipërmarrësit AMC sh.a për shërbimin publik telefonik të qëndrueshëm miratuar me VKD nr. 1648, datë 13.11.2011, vlerëson që në kushtet e përgjithshme të kontratës tip me pajtimtarin të pjesa “Hyrje” e saj të shtohen paragrafët e mëposhtëm:

*AMC do të zbatojë dispozitat e “Kushteve të përgjithshme të dhënies së shërbimeve të telefonisë publike të qëndrueshme për pajtimtarin”, për pajtimtarin me parapagim, për aq sa ato janë të zbatueshme për këtë kategori pajtimtarësh, duke i përfshirë këto në paketat e shitjes me parapagesë.*

*Pajtimtari me parapagim gëzon të drejta dhe ka detyrime që janë jo më pak të favorshme se ato të pajtimtareve me paspagim, në kushtet kur lloji i shërbimit është i njëjtë dhe i aplikueshem. Për pajtimtarët me parapagim, kushtet e veçanta të mënyrës së përdorimit të shërbimeve, përfshirë kreditimin nëpërmjet kartave rimbushese, afatet e përdorimit të tyre, paraqiten në udhëzuesin shoqerues të*

*kartave me parapagim, kartave rimbushese shoqëruese dhe informacioneve të tjera të publikuara nga AMC sh.a.*

5. Gjithashtu, AKEP me qëllim mbrojtjen sa më të mirë të konsumatorit, bazuar në:
  - i. Qëllimin e garantimit të shërbimeve të duhura dhe të përshtatshme në Shqipëri, të shprehur në nenin 1, të ligjit nr. 9918, dhe,
  - ii. Objektivat rregullatore për mbrojtjen e interesave të përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike, të shprehur në gërmat a) dhe b), pika 3, neni 7 i ligjit nr. 9918, çmon të arsyeshme miratimin e disa shtesave në Vendimin nr. 1648, datë 13.7.2011, dhe miratimin e formularit për regjistrimin me parapagesë për shërbimin telefonik të qendrueshëm për AMC sh.a,

### **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Këshilli Drejtues, duke konsideruar rëndësinë e miratimit të këtij dokumenti për sipërmarrësin dhe për pajtimtarët,

### **V E N D O S:**

1. Të miratojë, disa shtesa në Vendimin nr. 1648, datë 13.7.2011 të Këshillit Drejtues të AKEP *“Për Miratimin e Kushteve të Përgjithshme të Kontratës së Pajtitimit (Kontratë Tip) së Albanian Mobile Communications sh.a., për shërbimin publik telefonik të qendrueshëm”*, dhe *“Formularin e regjistrimit me parapagesë për pajtimtarin për shërbimin telefonik të qendrueshëm për AMC sh.a”*, depozituar në AKEP me shkresën nr. 635, datë 29.3.2012;
2. Albanian Mobile Communications sh.a.të publikojë në faqen e saj të Internetit Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (Kontratë Tip), të miratuara me këtë Vendim;
3. Të njoftohet AMC sh.a. për zbatimin e këtij Vendimi;
4. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit [www.akep.al](http://www.akep.al)

**K R Y E T A R I**

**Piro XHIXHO**

### **ANËTARË:**

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE